

Znj. Brunilda Zeneli (Hyka) është diplomuar për Financë në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, më pas ka kryer disa kualifikime, si: Certifikuar "Ekspert Kontabël dhe auditimi në Sektorin Publik" Chartered Institute of Public Finance and Accountancy (CIPFA) Angli & CEF-Slloveni, viti 2007; Certifikuar si Audit i Brendshëm në Sektorin Publik, nga Ministria e Financave, viti 2008; Diplomë "Postmaster në Administrim Biznes", Universiteti Jopublik "S&P Qirjazi" viti 2011; ka ndjekur Kursin Pasuniversitar, ku ka marrë Titullin "Vlerësues i pasurive të paluajtshme" Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Tiranës, viti 2015.

Znj. Brunilda Zeneli (Hyka), është Kryeaudituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit, prej Shtatorit të vitit 2022.

Nga viti 1990 deri në vitin 1998, ka punuar si financiere. Në vitin 1998-2006, ka mbajtur pozicionin e auditueses në KLSH. Nga viti 2007-2013, ka mbajtur pozicionin e Inspektorese në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Kryeministri, si dhe nga viti 2013 e në vazhdim ka mbajtur pozicionet si Audituese, Kryeaudituese në departamente të ndryshme auditimi si, në Departamentin e Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit; Departamentin e Auditimit të Performancës, Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore; Departamentin e Auditimit IT, Drejtorinë e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë. Në periudhën Maj 2020 deri në Shtator 2022, ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit, si dhe aktualisht Kryeaudituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit. Ka një eksperiencë të gjatë pune në fushën e auditimit dhe kontrollit, prej 24 vjetësh.

Gjithashtu, ka ndjekur një sërë trajnimesh të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, në fushën buxhetit "Planifikimi dhe zbatimi i buxhetit" nga Gjykata e Kontrollit Austri dhe nga Cards Project; "Mbi auditimin e shpenzimeve buxhetore", nga Këshilli Britanik, Shqipëri; në fushën e prokurimeve publike, "Mbi prokurimin e punëve publike", nga Qendra Ndërkombëtare e Trajnimeve ILO, në fushën e antikorrupsionit "Mbi forcimin e luftës kundër korrupsionit", nga Crown Agents dhe nga PNUD, "Shkëmbimi i eksperiencave mes vendeve të Europës Juglindore, në luftën kundër korrupsionit" nga Agjencioni Antikorrupsion Kosovë, "Korrupsioni dhe mashtrimi, roli i audituesve", nga Center of Excellence in Financë (CEF)-Slloveni, si dhe në fushën e auditimit, nga SAI i Turqisë, Polonisë, Austrisë etj.